

**VENDIM**  
**Nr. 362, datë 24.4.2013**

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETEVE KONTRAKTUESE, PËRKATËSISHT, MINISTRIA E  
MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE DHE MINISTRIA E PUNËVE  
PUBLIKE DHE TRANSPORTIT, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË MENAXHIMIT TË  
MBETJEVE TË AUTOMJETEVE NË FUND TË JETËS DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË  
PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË “KURUM  
INTERNACIONAL”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pikat 1, 3 e 23, pika 3 shkronja “b” të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Autoritete kontraktuese për kryerjen e procedurave ligjore dhe dhënien me koncesion të menaxhimit të mbetjeve të automjeteve në fund të jetës janë: Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Punëve Publike dhe Transportit.

2. Miratimin e bonusit prej 7 (shtatë) pikësh për rezultatin teknik, financiar dhe mjedisor në procedurën përzgjedhëse konkurruese (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Kurum Internacional”.

3. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Punëve Publike dhe Transportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**